

MASAT PARAMBROJTËSE:

- Ruajeni në vende të sigurta larg fëmijëve.
- Ruajeni larg ushqimeve për blegtorinë si dhe pijeve dhe ushqimeve për njerëzit.
- Gjatë punës mos hani dhe mos pini lëngje e duhan.
- Vishni rrobat e punës dhe pajisjet mbrojtëse.
- Pas punës lani duart dhe pjesët e ekspozuara të trupit.
- Lani pajisjet mbrojtëse, mjetet e spërkatjes.
- Bëni shkatërrimin e ambalazhit sipas rregullave në fuqi.

UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN:

- Në rast kontakti me sytë, lajini menjëherë me ujë të bollshëm së paku 15 minuta dhe kërkoni ndihmë mjekësore.
- Në rast gëllitjeje, pini 1-2 gota ujë dhe provokoni të vjella.
- Në rast thithjeje avujsh, nxirreni të dëmtuarin në ajër të pastër.
- Nqs humb ndërgjegjen bëjini frymëmarrje artificiale dhe kur frymëmarrja është e vështirë jepni oksigjen dhe kërkoni ndihmë mjekësore në qendrën më të afërt spitalore, duke i treguar mjekut etiketën.
- Nuk njihet antidot specifik. Mjekimi simptomatik.



Data e prodhimit: Printuar në ambalazh
Afati i ruajtjes: 3 vjet

1 Lit

NIMROD 250EW

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE

Lënda vepruese: *Bupirimate 250g/lit.*

Formulimi: *Emulsion ujqor (EW)*

Nr. i regjistrimit: *569; datë 17/09/2014*



FUNGICID SISTEMI, SPECIFIK KUNDER HIRIT, ME VEPRIM PARANDALUES, KURATIV DHE ÇRRENJOSËS

 **MELDI** Sh.p.k

Distributor:
MELDI Sh.p.k.
Tiranë - Shqipëri



Aplikant: **ADAMA Agriculture BV**
Prodhuesi: **ADAMA Makhteshim Ltd,**
Israel

Përdorimi:

NIMROD është fungicid sistemik, me veprim parandalues, kurativ dhe çrrenjosës, që përmban BUPIRIMAT, e vetmja lëndë aktive e familjes kimike të Hidroksipirimidinave, që karakterizohet nga një mekanizëm veprimi unik e të vecantë, specifik kundër hirit në vreshtari, pemë frutore, perime e bimë zbukuruese.

Në vreshtë: trajtimet fillojnë nga momenti i lulëzimit si parandalues, me 0.8-1.3 lit/ha; në rast përzierje (mishelë) me produktet që përmbajnë Tebuconazole, doza ulet në 0.7 lit/ha. Në prani të infeksionit në veshulë përdoret me 1-1.3 lit/ha, duke e përsëritur trajtimin pas 5-6 ditësh.

Në mollë: me 30-60 ml/100 lit ujë. Trajtimet fillojnë në fazën e veshëve të miut.

Në pjeshkë e kajsi: me 50-100ml/100 lit ujë. Trajtimet fillojnë në prag të lulëzimit.

Në domate, patëllxhan, specia: me 200-300ml/100lit ujë.

Shalqi, pjepër: me 50-100ml/100 lit ujë.

Kastravec e kungull: me 100ml/100 lit ujë

Luleshtrydhe: me 1 lit/ha.

Trëndafila e bimë zbukuruese: me 150-300 ml/100lit ujë.

Doza më e lartë përdoret në infeksionet e rënda.

Vërejtje për përdorimin: Përzihet me shumicën e insekticideve dhe fungicideve të përdorura në bujqësi.

Nuk lejohet përzjerja me produktet alkaline. Lejon përzjerjen edhe me vajrat minerale.

Karenca: 14 ditë për drufrutorët dhe rrushin; 3 ditë për perimet e luleshtrydhen.

Ndikimi në ekosistem: Pak helmues për gjitarët. Pak helmues për bletën dhe faunën e dobishme.

Mesatarisht helmues për peshqit. Mos ndotni kanalet, ujëmbledhësat dhe burimet e tjera ujore me ambalazhin apo me solucionin spërkatës.

Fitotoksiciteti: Nuk është fitotoksik në kulturat dhe dozat e rekomanduara. Mund të shfaqë shenjë fitotoksiciteti tek varietetet e mollës Gravestein, Idaret, Imperator nëse përdoret pas fazës së "butonave rozë".

Magazinimi: Ruajeni në ambalazhin original, të mbyllur mirë, në vende të thata, të errëta dhe të ventiluara, në temperaturat nga 10-30°C.

